LIGJ
Nr.7669, datë 2.2.1993

PËR PAGAT E ANËTARËVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" dhe të nenit 30 të ligjit nr. 7561, datë 29.4.1991 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Pagat e anëtarëve të zgjedhur të Gjykatës Kushtetuese janë:

Pagat e Kryetarit	9500 lekë
Pagat e anëtarëve	8500 lekë

Neni 2

Personat e përmendur në këtë ligj përfitojnë të drejtën e shtesës së pagës njëlloj si punonjësit e tjerë të institucioneve buxhetore.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.456, datë 10.2.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.